

VENDIM
Nr. 534, datë 7.8.2012

PËR HEQJEN E LICENCËS SË KOLEGJIT PROFESIONAL PRIVAT “DENTARIUM-AL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 pika 8 e 45 pika 4 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës kolegjit profesional privat “Dentarium-AL” dhe të lejeve për hapjen e programeve të studimeve, në zbatim të saj.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha